

I. Universiteti Politeknik i Tiranës, shpall 1 (një) vend pune për personel ndihmësakademik pranë Fakultetit të Teknologjisë së Informacionit si më poshtë:

A. 1 (një) vend pune për personel ndihmësakademik në pozicionin “Laborant” në Departamentin e Bazave të Informatikës.

Kandidati duhet të plotësojë kriteret përcaktuese si më poshtë:

1. Të zotërojë një diplomë minimalisht 3-vjeçare (Bachelor) në Inxhinieri Informatike, Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit, Universiteti Politeknik i Tiranës.
2. Të njohë një gjuhë të huaj dhe të paraqesë dëshminë/certifikatën përkatëse që vërteton njohjen e saj.
3. Të ketë aftësi të mira komunikimi si dhe aftësi të punës në grup. Preferohet dëshira për rritje profesionale dhe inovacion.
4. Të ketë një letër rekomandimi nga staf akademik i Universitetit/Fakultetit ku kandidati ka kryer studimet, me datë jo më të hershme se data e shpalljes së njoftimit të punësimit.

II. DOKUMENTACIONI DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentet si më poshtë:

1. Letër motivimi;
2. Jetëshkrimi (CV) sipas formatit standard;
3. Fotokopje të pasaportës ose kartës së identitetit;
4. Diplomën e studimeve universitare dhe listën e notave të noterizuara; (Aplikantët që kanë kryer studime jashtë shtetit duhet të kenë bërë njohjen e diplomave nga MAS);
5. Fotokopje të librezës së punës të noterizuar;
6. Vetëdeklarimin e gjendjes gjyqësore;
7. Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
8. Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin e paraqitur;
9. Dëshminë e gjuhës së huaj e noterizuar.

Të gjithë kandidatët duhet të paraqesin brenda datës **12.11.2025** pranë Drejtorisë së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore dhe Juridike në Rektoratin e Universitetit Politeknik të Tiranës, dokumentacionin e sipërcituar.